



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) për raportimin e kryer për Programin Kombëtar të modernizimit të sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI

MBI “AUDITIMIN FINANCIAR”

NË

**AGJENCINË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE (AKUK) PËR RAPORTIMIN E KRYER PËR
PROGRAMIN KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË
SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË
SHQIPËRI**

TIRANË, dhjetor 2024

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II	HYRJA	
1	Objektivat dhe qëllimi	
2	Identifikimi i çështjes	
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4	Përgjegjësitë e audituesve	
5	Kriteret e vlerësimit	
6	Standardet e auditimit	
7	Metodat e auditimit	
8	Dokumentimi i auditimit	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Auditimi i subvencioneve të dhëna nga AKUK për ujësjellësat për vitin 2020 dhe 2021 (lidhet me rezultatet përpara bërjes efektive të programit)	
2.2	Auditi i raportit vjetor financiar të programit që përfshin shpenzimet korrente të AKUK dhe shpenzimet kapitale specifike të përzgjedhura për arritjen e objektivave të programit për vitin 2023	
IV	REKOMANDIME	

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Për realizimin e projektit është lidhur marrëveshja e huasë në shumën 67.3 mln euro, e ratifikuar me Ligjin nr. 25, datë 23.03.2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare Për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”.

Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operationale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjellësit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme:

Pjesa 1. Forcimi i Kuadrit Sektorial Kombëtar

1. Miratimi i udhëzimeve të politikave me kriteret e përshtatshmërisë dhe metodologjinë për ndarjen e subvencioneve të financuara nga buxheti fiskal për NJQV-të dhe ndërmarrjet UK nga AKUM-i, në lidhje me sa vijon:

i. grante për NJQV dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar mungesat e të ardhurave si një përgjigje emergjente ndaj situatës së COVID-19 (“Grantet e COVID-19”) dhe grante të bazuara në performancë për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar shpenzimet operationale (“Grante të bazuara në performancë”);

ii. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në eficiencë dhe përmirësimin e performancës, duke përfshirë infrastrukturën e ujësjellësit për vazhdimësinë e shërbimit, ngritjen e zonave të matura në rrethe, reduktimin e ujit pa të ardhura, matjen e vëllimeve të ujit dhe përmirësime të tjera në zonat urbane dhe zonat rurale, investimet për eficiencën e energjisë dhe masat e ndryshimit të ndërmarrjeve (“Grantet e Investimeve”);

iii. stimuj për proceset e grumbullimit ose ristrukturimit për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK (“Stimujt”); dhe

iv. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në lidhjet e reja të ujësjellësit në zonat e pafurnizuara periurbane dhe rurale, duke përfshirë familjet në nevojë (“Grante Investimi për Lidhje të Reja”).

2. Mbështetja e koordinimit ndërmjet AKUM-it dhe ERRU-së për të kërkuar rregullimin e politikave në përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe për të promovuar miratimin e një udhëzuesi për planin e biznesit në përputhje me kërkesat rregullatore.

3. Mbështetja: i. e përhapjes së sistemit kombëtar të informacionit për të përmirësuar besueshmërinë e të dhënave të performancës/vlerësimit të ndërmarrjeve dhe duke mundësuar monitorimin e treguesve kryesorë të performancës së ndërmarrjes; ii. miratimin e programit kombëtar të certifikimit për stafin e ndërmarrjeve UK; dhe iii. forcimin e kërkesave ekzistuese të qeverisjes korporative dhe mekanizmave të korrigjimit të ankesave, menaxhimin e aktiveve dhe sistemet e informacionit të menaxhimit në nivel lokal dhe qendror.

Pjesa 2. Përmirësimi i Performancës Operationale dhe Financiare të Ndërmarrjeve UK

1. Financimi: a) i Granteve të COVID-19; dhe b) Grantet e Bazuara në Performancë për NjQV-të e përzgjedhura dhe/ose Ndërmarrjet UK.

2. Financimi i Granteve të Investimeve për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK.

3. Stimuj financimi për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose ndërmarrjet UK.

Pjesa 3. Mbyllja e mangësive të Shërbimeve të Përgjithshme të Aksesit të Ujësjellësit

1. Financimi i Granteve të Investimeve të Lidhjes së Re për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK-së.

Nga auditimi rezultuan në mënyrë të përmbledhur:

AKUK akordon çdo vit subvencion për Ujësjellës Kanalizimet që janë në vështirësi financiare dhe ekonomike. Rezulton se për vitin 2020 janë dhënë 3 lloje subvencionesh (për energjinë elektrike, Covid-19 dhe detyrimet tatimore) ndërsa për vitin 2021 dhe 2023 subvencioni është dhënë për energji elektrike. Rezulton se situata financiare e ujësjellësve është jo e mirë pasi subvencionet janë përdorur për të kryer pagesat e pagave të punonjësve, sigurimeve shoqërore

dhe tatimeve të cilat janë detyrime të mbartura. Gjithashtu konstatohet se ujësjellësat kanë detyrime energjie elektrike të mbartura duke e rënduar edhe më tepër situatën me kamatëvonesa për mos shlyerje detyrimesh në kohë.

Pasqyrat financiare të AKUK mbahen në programin Excel (manualisht) dhe jo të integruara me sistemin e Thesarit apo programeve për këtë qëllim. Ky fakt sjell si pasojë riskun e shtuar për ndërhyrje të mundshme mbi vlerat e raportuara në çdo moment dhe duke mos lenë asnjë gjurmë.

Rezulton së vlerat e raportuara te Banka Botërore janë vlerat e marra nga sistemi i thesarit dhe jo ato të pasqyrave financiare.

Nga auditimi i veprimeve të kryera me llogaritë 600 (Pagat) dhe 601 (Sigurime shoqërore) konstatohet se kontabilizimet kanë qenë të sakta por:

- Në llogarinë 600 në muajin dhjetor vlera e raportuar te BB është 324,147 lekë me e lartë se totali i listëpagesës pasi është përfshirë edhe shpërblimi i dy punonjësve.

- Në llogarinë 601 në muajin nëntor nga totali i listëpagesës ka ngelur pa paguar vlera prej 88,055 lekë, vlerë e cila është paguar muajin janar, si dhe në vlerën e TAP është përfshirë edhe vlera e mbajtur nga shpërblimin i dhënë për dy punonjësit prej 60,004 lekë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera me llogarinë 602 (Mallra dhe Shërbime të Tjera) u konstatua se janë kryer pagesa çdo muaj për vitin 2023 për një punonjës këshilltar të jashtëm të Drejtorit të Përgjithshëm të KLSH bazuar në kontratë shërbimi. Nga vlera e paguar është mbajtur tatimi në burim në masën 15%. Kjo marrëdhënie pune e trajtuar si kontratë shërbimi është në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nuk janë mbajtur sigurimet shoqërore dhe shëndetësore përkatëse.

Disa nga rekomandimet kryesore:

AKUK të marrë masa për hartimin e një kuadri rregullator detyruar për të gjithë Shoqëritë Rajonale ku të përcaktohet rendi i kryerjes se pagesave dhe prioritizohen në këtë rend pagesat e pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore, pagesa e energjisë elektrike etj., si pagesa kryesore për cilësinë e jetës së komunitetit.

AKUK të marrë masa për integrimin e një sistemi (software) financiar për hartimin e pasqyrave financiare të saj, ku të jenë të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës që ka akses në sistem, duke ruajtur besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në to.

AKUK të marrë masa në saktësimin e vlerave të përfshira në llogaritë e përfshira në raportimin e kryer te Banka Botërore.

AKUK të marrë masa të lidhë kontratë pune për këshilltarin e jashtëm të Drejtorin të Përgjithshëm si dhe të aplikohen, mbahen dhe paguhen të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar raportin financiar të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve për llogari të Bankës Botërore (BB) si detyrim që rrjedh nga marrëveshja e financimit, për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në raportin financiar, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të llogarive financiare.

Opinionin i pa modifikuar¹ :

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në llogaritë e sipërpërmendura të subjektit AKUK nuk janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, dhe në gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një opinionin të pa modifikuar.

Baza për opinionin e pa modifikuar:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit tonë përfundimtar.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n, ISSAI 200 Parimet e Auditimit Financiar dhe ISA 800 (ISSAI 2800, Konsiderata të veçanta, auditime të pasqyrave financiare të hartuara sipas një kuadri të veçantë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

AKUK akordon çdo vit subvencion për Ujësjellës Kanalizimet që janë në vështirësi financiare dhe ekonomike. Rezulton se për vitin 2020 janë dhënë 3 lloje subvencionesh (për energjinë elektrike, Covid dhe detyrimet tatimore) ndërsa për vitin 2021 dhe 2023 subvencioni është dhënë për energji elektrike. Rezulton se situata financiare e ujësjellësve është jo e mirë pasi subvencionet janë përdorur për të kryer pagesat e pagave të punonjësve, sigurime shoqërore dhe tatime të cilat janë detyrime të mbartura. Gjithashtu konstatohet se ujësjellësit kanë detyrime energji elektrike të mbartura duke e rënduar edhe më tepër situatën me kamatëvonesa për mos shlyerje detyrimesh në kohë.

Vlerat e raportuara tek BB për llogarinë 603 janë vetëm vlerat e subvencionit të akorduar dhe jo vlerat e pagura realisht nga sistemi i thesarit.

Nga AKUK nuk ka asnjë evidencë apo dokumentacion mbi përdorimin faktik të vlerave të akorduara si subvencion për Ujësjellësit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim: AKUK është përgjegjës për paraqitjen e saktë dhe me besueshmëri të raportit financiar, si dhe në kryerjen e veprimtarive, duke respektuar parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre. Gjithashtu, ata janë përgjegjës për përcaktimin, njohjen, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare që lidhen me veprimtarinë e saj publike.

Përgjegjësia e audituesve të KLSH, është që të shprehin një opinion për pasqyrat financiare, ose pjesë të tyre në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesve të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare, (llogaritë përkatëse) në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit. Kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, konsiderohet nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund

¹ -Manuali Auditimit Financiar, llojet e opinioneve, fq. 55-66.

-(e shkëputur nga ISSAI 200) Forma e opinionit 147. Audituesi duhet të japë një opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu ka aplikuar edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Ne gjithashtu: Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi ka marrë në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 852/1 prot., datë 18.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.09.2024 deri në datën 31/10.2024, në Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve (AKUK) periudhën nga 01/01/2023 deri në datën 31.12.2023, si dhe për vitet 2020 dhe 2021 për subvencionin e dhënë nga AKUM për Ujësjetllës, u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve për raportimin e kryer për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve në Shqipëri (Programi)”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I. S., Përgjegjës i Grupit
2. I. B., Audituese
3. V. B., Audituese
4. J. B., Audituese

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Dhënia e opinionit financiar me një siguri të arsyeshme nga ana e audituesve nëse transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike të Programit janë raportuar drejt dhe saktë në raportimin e kryer nga subjekti i audituar për Bankën Botërore për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 si dhe subvencionet e dhëna nga AKUK për Ujësjetllës për vitin 2020 dhe 2021 nëse janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

2. Identifikimi i çështjes:

Për auditimin Financiar, qëllimi i tij është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të raporteve financiare të raportuara nga AKUK për vitin 2023 si dhe subvencionet e dhëna nga AKUK për Ujësjetllës për vitin 2020 dhe 2021. Auditimi financiar do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) – ANEKSI A, dhe standardet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një anëtar i INTOSAI-t. Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të testit, të provave që mbështesin shumat dhe dhënieve të informacioneve shpjeguese në raportet financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të

kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të raporteve financiare.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat në Agjencia Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) janë përgjegjëse për raportimin drejtë dhe saktë të transaksioneve financiare për llogaritë 600, 601, 602, 603 dhe 231.

4. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj.. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. Nr. 25/2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”. Kushtet për përgjithshme të marrëveshjes në fjalë.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”;

Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;

Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

Udhëzim i MF nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”;

Udhëzimin e MF nr. 20, datë 24.12.2003 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësive të menaxhimit, zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”;

Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësive të Menaxhimit të Projekteve etj.

6. Standardet e auditimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 200; 400 etj.;

ISSAI 5220 Udhëzime Mbi praktikat më të mira të auditimit të financimit privat /publik dhe koncesioneve

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë-KLSH;

Manuali i Auditimi Financiar-KLSH;

7. Metodatat e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

8. Dokumentimi i auditimit:

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt konstatimeve dhe akt verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projekt Raporti i Auditimit, i cili ka shërbyer si materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Për realizimin e projektit është lidhur marrëveshja e huasë në shumën 67.3 mln euro, e ratifikuar me Ligjin nr. 25, datë 23.03.2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare Për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”.

Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operationale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjellësit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Auditimi i subvencioneve të dhëna nga AKUK për ujësjellësat për vitin 2020 dhe 2021 (lidhet me rezultatet përpara bërjes efektive të programit)

Për realizimin e projektit është lidhur marrëveshja e huasë në shumën 67.3 mln euro, e ratifikuar me Ligjin nr. 25, datë 23.03.2023 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare Për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”.

Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operationale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjellësit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme:

Pjesa 1. Forcimi i Kuadrit Sektorial Kombëtar

1. Miratimi i udhëzimeve të politikave me kriteret e përshtatshmërisë dhe metodologjinë për ndarjen e subvencioneve të financuara nga buxheti fiskal për NJQV-të dhe ndërmarrjet UK nga AKUM-i, në lidhje me sa vijon:

i. grante për NJQV dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar mungesat e të ardhurave si një përgjigje emergjente ndaj situatës së COVID-19 (“Grantet e COVID-19”) dhe grante të bazuara në performancë për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar shpenzimet operationale (“Grante të bazuara në performancë”);

ii. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në eficiencë dhe përmirësimin e performancës, duke përfshirë infrastrukturën e ujësjellësit për vazhdimësinë e shërbimit, ngritjen e zonave të matura në rrethe, reduktimin e ujit pa të ardhura, matjen e vëllimeve të ujit dhe përmirësime të tjera në zonat urbane dhe zonat rurale, investimet për eficiencën e energjisë dhe masat e ndryshimit të ndërmarrjeve (“Grantet e Investimeve”);

iii. stimuj për proceset e grumbullimit ose ristrukturimit për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK (“Stimujt”); dhe

iv. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në lidhjet e reja të ujësjellësit në zonat e pafurnizuara periurbane dhe rurale, duke përfshirë familjet në nevojë (“Grante Investimi për Lidhje të Reja”).

2. Mbështetja e koordinimit ndërmjet AKUM-it dhe ERRU-së për të kërkuar rregullimin e politikave në përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe për të promovuar miratimin e një udhëzuesi për planin e biznesit në përputhje me kërkesat rregullatore.

3. Mbështetja: i. e përhapjes së sistemit kombëtar të informacionit për të përmirësuar besueshmërinë e të dhënave të performancës/vlerësimit të ndërmarrjeve dhe duke mundësuar monitorimin e treguesve kryesorë të performancës së ndërmarrjes; ii. miratimin e programit kombëtar të certifikimit për stafin e ndërmarrjeve UK; dhe iii. forcimin e kërkesave ekzistuese

të qeverisjes korporative dhe mekanizmeve të korigjimit të ankesave, menaxhimin e aktiveve dhe sistemet e informacionit të menaxhimit në nivel lokal dhe qendror.

Pjesa 2. Përmirësimi i Performancës Operacionale dhe Financiare të Ndërmarrjeve UK

1. Financimi: a) i Granteve të COVID-19; dhe b) Grantet e Bazuara në Performancë për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose Ndërmarrjet UK.

2. Financimi i Granteve të Investimeve për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK.

3. Stimuj financimi për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose ndërmarrjet UK.

Pjesa 3. Mbyllja e mangësive të Shërbimeve të Përgjithshme të Aksesit të Ujësjetës

1. Financimi i Granteve të Investimeve të Lidhjes së Re për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK-së.

Skema e disbursimit:

<u>Kategoria (duke përfshirë treguesin që lidhet me disbursimin, sipas rastit)</u>	<u>Rezultati që lidhet me disbursimin (sipas rastit)</u>	<u>Shuma e Huasë së Alokuar (e shprehur në euro)</u>	<u>Formula e Disbursimit</u>
1. DLI #1: Përmirësimi i mekanizmeve të financimit të sektorit dhe stimujve për performancën e përshtatur	DLR #1.1 Huamarrësi ka miratuar udhëzuesit e rinj në vijim të kriterëve të pranueshmërisë dhe metodologjisë së bazuar në performancë për alokimin e subvencioneve nga buxheti i shtetit dhe monitorimin e përdorimit të tyre nga Ndërmarrjet e UK-së: i. Udhëzues mbi subvencionet për ndikimet dhe shpenzimet operacionale të COVID-19. ii. Udhëzues mbi subvencionet për investimet kapitale në përmirësimin e efikasitetit operacional dhe gjendjes financiare. iii. Udhëzues mbi subvencionet për stimujt për grumbullimin ose ristrukturimin e ndërmarrjeve të UK-së. iv. Udhëzues mbi subvencionet për investimet kapitale për akses të ri në shërbimet e furnizimit me ujë në zonat e pafurnizuara.	9,000,000	1,800,000 € për çdo udhëzues sipas DLR 1.1 (i), (ii), (iii) dhe (iv) dhe 1,800,000 € kur të gjitha udhëzimet e përmendura janë plotësuar, deri në 9,000,000 €
2. DLI #2: Përmirësimi i alokimit të shpenzimeve publike për sektorin e UK-së	DLR # 2.1 AKUM ka alokuar në planin e tij buxhetor afatmesëm grante për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet e UK-së në përputhje me udhëzimet e miratuara sipas DLR ll (i), 1.1 (ii), dhe 1.1 (iii) dhe (iv).	22,131,750	1 € për çdo ekuivalent 1 € të alokuar deri në 22,131,750 €
3. DLI #3: Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të sektorit të UK-së	DLR #3.1 10% Rezultati i Përmbledhur Kombëtar i Përmirësuar për Mbulimin e Drejtpërdrejtë të Kostos së Funkcionimit, nga viti bazë 2022.	9,000,000	900,000 € për çdo rritje me 1% nga viti bazë 2022, deri në 9,000,000 €
4. DLI #4: Vazhdimësia e përmirësuar e shërbimeve të ujësjetës	DLR # 4.1 Të paktën tridhjetë e pesë Zona Urbane me një minimum prej 18 orësh furnizimi me ujë nga një bazë prej pesëmbëdhjetë Zonash Urbane	9,000,000	450,000 € për çdo Zonë të re Urbane deri në 9,000,000 €

5. DLI #5: Numri i lidhjeve të reja funksionale të familjeve që ofrojnë shërbime të sigurta dhe të besueshme të ujit	DLR #5.1 Lidhje të reja funksionale të ujit në familjet jo të cenueshme, nga një bazë prej 0. DRI #5.2 Lidhje të reja funksionale të ujit për familjet e cenuara, nga një bazë prej 0.	18,000,000	i. 1,400 € për çdo lidhje të re të ujit në familjet jo të cenueshme, deri në 12,600,000 €; dhe ii. 1,800 € për çdo lidhje të re të ujit në familjet e cenuara, deri në një shumë totale prej 18,000,000 € si për familjet jo të cenuara (DLR#5.1) dhe për familjet e cenuara (DLR#5.2).
4. Komisioni paraprak duhet të paguhet në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.05 (b) të Kushteve të Përgjithshme		168,250	
5. “Kufiri i normës së interesit ose kufiri i primit të normës së interesit që duhet paguar në përputhje me seksionin 4.05 (c) të Kushteve të Përgjithshme			
SHUMA TOTALE		67.300.000	

Bazuar në pikën 56 të PAD (Dokumenti i Vlerësimit të Programit) si dhe kërkesës së BB, KLSH do të auditojë raportet financiare të programit, konkretisht:

“56. Marrëveshjet e disbursimit

Disbursimet do të bëhen mbi bazën e rezultateve të verifikuara, sipas DLI. Për çdo DLI, shumat e alokuara, afatet kohore, objektivat vjetore, kushtet për arritjen e rezultateve, paradhëniet, financimi i rezultateve paraprake, afatet për arritje dhe përcaktimi i shumës që do të disbursohet janë përcaktuar në Aneksin 2. Qeveria Shqiptare do të duhet të provojë që, nëpërmjet pasqyrave financiare të përgatitura rregullisht, shpenzimet neto të Programit janë të barabarta ose më shumë se shumat e financimit të Programit të Bankës. Deklaratat Financiare të Programit do të auditohen çdo vit nga Institucioni i Lartë Kombëtar i Auditimit (KLSH). Për rezultatet e mëparshme për këtë operacion parashikohet financimi në masën maksimale prej 3 milionë USD²...”

Nga Banka u vendosën në dispozicion raportet e dorëzuara nga AKUK për subvencionin e dhënë për vitet 2020 dhe 2021 nga AKUK për ujësjellësat lidhur me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, si dhe shpenzimet direkte dhe shpenzimet kapitale specifike të përzgjedhura për arritjen e objektivave të programit.

Për vitin 2020

a) Subvencioni për energjinë elektrike

Në bazë të Udhëzimit nr. 3, datë 18.06.2020 “Për miratimin e Metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencionin shtetëror, për Shoqëritë Aksionare të ujësjellës kanalizimeve për vitin buxhetor 2020 dhe 2021”, pika 4: “*Prioritet në ndarjen e fondit, që do të akordohet sipas pikës 3(b), do të kenë ato shoqëri aksionare të Ujësjellës Kanalizimeve, të cilat ujin e prodhojnë me ngritje mekanike, për shkak të të cilit kostoja e energjisë është e lartë*”, është kryer shpërndarja e subvencionit të vitit 2020.”

² Rezultatet e mëparshme do të lidhen me subvencionin e dhënë për vitet 2020 dhe 2021

Duke krahasuar vlerat e raportuara nga AKUK te Banka Botërore me emailin e datës 03.02.2022 (shkresa nr. 2244 prot., datë 02.09.2020 “Akordimi i subvencionit për vitin 2020”) dhe shkresës së nr. 2256/10 prot., datë 01.09.2020 “Dërgojmë miratimin e detajimit të subvencionit të ujit për vitin 2020” sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 1: Vlerat e raportuara dhe vlerat faktike

Etniteti i Qeverisjes	Kodi i Institucionit	Emër Institucioni	Diferencë Kostoje për faturat energjisë elektrike (lekë)	Raportimi te Banka Botërore (lekë)	Diferenca (lekë)
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(4)-(5)=(6)
		Pakësohet	150,000,000		
001	1006047	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	150,000,000		
		Shtohet	150,000,000		
152	2152001	Belsh SHA	1,962,500	1,962,500	0
110	2110001	Cërrik SHA	2,758,800	2,758,800	0
139	2139010	Çorovodë U SHA	1,022,800	1,022,800	0
104	2104004	Delvinë U SHA	361,000	361,000	0
147	2147002	Divjakë SHA U	2,600,400	2,600,400	0
107	2107018	Durrës SHA	30,175,200	30,175,200	0
109	2109015	Elbasan SHA	3,884,900	3,884,900	0
117	2117002	Has U SHA	827,000	827,000	0
166	2166003	Kamëz SHA	5,836,700	5,836,700	0
118	2118009	Kavajë UK SHA	12,354,100	12,354,100	0
154	2154002	Këlcyrë SHA	711,000	711,000	0
156	2156001	Konispol	2,026,500	2,026,500	0
123	2123002	Krujë UK SHA	2,063,500	2,063,500	0
126	2126007	Kurbini U SHA	8,475,900	8,475,900	0
129	2129008	Lushnjë SHA	5,608,100	5,608,100	0
168	2168002	Maliq SHA	1,040,400	1,040,400	0
131	2131009	Mallakastër UK SHA	3,915,100	3,915,100	0
112	2112006	Patos U SHA	12,346,100	12,346,100	0
134	2134003	Peqin UK SHA	3,773,500	3,773,000	0
140	2140002	Polçan U SHA	675,100	675,100	0
113	2113001	Roskovec	707,100	707,100	0
119	2119004	Rrogozhinë UK SHA	2,374,300	2,374,300	0
159	2159002	Selenicë UK SHA	1,205,000	1,205,000	0
141	2141032	Shkodër SHA	7,207,900	7,207,900	0
167	2167002	Ura-Vajgurore U SHA	2,909,100	2,909,100	0
157	2157003	Vau Dejës U SHA	1,063,400	1,063,400	0
146	2146029	Vlorë SHA	30,429,000	30,429,000	0
165	2165003	Vorë SHA	1,685,600	1,685,600	0

Burimi: Të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga krahasimi i vlerave të raportuara te Banka Botërore rezulton se nuk ka diferenca në raportim.

Grupi i auditimit përzgjedhi subvencionet e 5 SHA, konkretisht: Durrës, Patos, Vlorë, Lushnjë dhe Has

U krye verifikimi i transaksioneve të kryera si më poshtë:

Has: Me Urdhër-shpenzimin nr. 9, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 522,329 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 10, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 24,528 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr.11, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 31,652 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 12, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 105,958 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 13, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 126,302 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 20, datë 13.10.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 8,837 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 23, datë 13.11.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 5,175 lekë;

Bashkëlidhur janë faturat e energjisë elektrike.

Në total vlera e paguar sipas urdhërshpenzimeve është 824,781 lekë.

Nga auditimi rezulton se ka një diferencë prej 2,219 lekë e raportuar më shumë të Banka Botërore.

Vlorë: Me Urdhër-shpenzimin nr. 1, datë 08.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 30,429,000 lekë;

Me shkresën nr. 473, datë 04.09.2020 i janë akorduar Ujesjellës Kanalizimeve Vlorë Sha vlera prej 30,429,000 lekë;

Bashkëlidhur është përmbledhëse e detyrimeve për energjinë elektrike.

Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

Durrës: Me Urdhër-shpenzimin nr. 15, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 30,175,200 lekë;

Bashkëlidhur pagesës situacioni me nr. 2560 prot., datë 28.08.2020 i Ujesjellës Kanalizimeve Durrës Sha me vlerën 30,175,200 lekë , si dhe kartela kontabël përkatëse.

Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

Lushnje: Me Urdhër-shpenzimin nr. 1, datë 29.09.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 5,608,100 lekë;

Bashkëlidhur faturat e enegjisë elektike.

Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

Patos: Me Urdhër-shpenzimin nr. 1, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për Energji Elektrike për llogari të FSHU në vlerën 12,346,100 lekë;

Bashkëlidhur Akt-rakordimi i datës 31.08.2020.

Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

b) Subvencion Covid

Në bazë të Udhëzimit nr. 3, datë 18.06.2020 “pika 7: “Subvencioni që do tu akordohet shoqërive aksionare të Ujësjetllës Kanalizimeve, sipas pikës 3(a), do të jetë sipas kërkesave të argumentuara, në vlerë, që do të paraqesi shoëritë ujësjetllës kanalizime pranë AKUMS për problemet që kanë hasur gjtë periudhës Covid 19. ”, është kryer shpërndarja e subvencionit të vitit 2020.

Plotësojeni

Etniteti i Qeverisjes	Kodi i Institucionit	Emër Institucioni	Subvencioni për Covid-19	Raportimi te Banka Botërore	Diferenca
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(4)-(5)=(6)
		Pakësohet	150,000,000		

001	1006047	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	150,000,000		
		Shtohet	150,000,000		
152	2152001	Belsh SHA	5,000,000	5,000,000	0
105	2105002	Bilisht SHA	1,200,000	1,200,000	0
103	2103007	Bulqizë U SHA	2,400,000	2,400,000	0
132	2132006	Burrel SHA	3,000,000	3,000,000	0
110	2110001	Cërrik SHA	4,000,000	4,000,000	0
139	2139010	Çorovodë U SHA	5,500,000	5,500,000	0
104	2104004	Delvinë U SHA	4,800,000	4,800,000	0
147	2147002	Divjakë SHA U	2,500,000	2,500,000	0
120	2120005	Ersekë SHA	3,000,000	3,000,000	0
155	2155003	Fush Arrëz UK SHA	1,700,000	1,700,000	0
114	2114015	Gramsh SHA	2,000,000	2,000,000	0
117	2117002	Has U SHA	5,000,000	5,000,000	0
154	2154002	Këlcyrë SHA	3,500,000	3,500,000	0
123	2123002	Krujë UK SHA	10,000,000	10,000,000	0
125	2125017	Kukës SHA	3,500,000	3,500,000	0
126	2126007	Kurbin U SHA	6,000,000	6,000,000	0
116	2116005	Libohovë SHA	2,500,000	2,500,000	0
131	2131009	Mallakastër UK SHA	10,000,000	10,000,000	0
133	2133005	Mirditë UK SHA	4,500,000	4,500,000	0
112	2112006	Patos U SHA	18,500,000	18,500,000	0
134	2134003	Peqin UK SHA	9,000,000	9,000,000	0
135	2135007	Përmet U SHA	1,000,000	1,000,000	0
106	2106012	Peshkopi SHA	5,500,000	5,500,000	0
140	2140002	Polçan U SHA	2,000,000	2,000,000	0
137	2137020	Pukë SHA	2,500,000	2,500,000	0
499	2499002	Pustec SHA	1,100,000	1,100,000	0
113	2113001	Roskovec	500,000	500,000	0
119	2119004	Rrogozhinë UK SHA	6,000,000	6,000,000	0
159	2159002	Selenicë UK SHA	4,000,000	4,000,000	0
142	2142009	Tepelenë U SHA	1,500,000	1,500,000	0
145	2145010	Tropojë U SHA	2,000,000	2,000,000	0
167	2167002	Ura-Vajgurore SHA	4,300,000	4,300,000	0
157	2157003	Vau Dejës U SHA	7,000,000	7,000,000	0
165	2165003	Vorë SHA	5,000,000	5,000,000	0

Nga krahasimi i vlerave të raportuara te Banka Botërore rezulton se nuk ka diferenca në raportim.

Grupi i auditimit përzgjedhi subvencionet e 5 SHA, konkretisht:

Has

Kruja

Mallakastër

Rrogozhinë

Patos

Vau i Dejës

Has

Me Urdhër-shpenzimin nr. 1, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 275,438 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 2, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 278,450 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 3, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 278,450 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 4, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 283,727 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 5, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 300,212 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 6, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 304,768 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 7, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 294,093 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 8, datë 21.08.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 301,455 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 14, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për paga punonjësish 885,324 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 15, datë 09.09.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 304,668 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 16, datë 09.09.2020, është kryer pagesa blerje klor 70,000 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 17, datë 09.09.2020, është kryer pagesa blerje disinfektanti 50,000 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 18, datë 01.10.2020, është kryer pagesa paga punonjësish 897,735 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 19, datë 01.10.2020, është kryer pagesa për Detyrim Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 307,719 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 21, datë 02.11.2020, është kryer pagesa për paga punonjësish 159,495 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 22, datë 02.11.2020, është kryer pagesa për maska mbrojtëse 8,470 lekë;
Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

Mallakastër

Me Urdhër-shpenzimin nr. 13, datë 02.09.2020, është kryer pagesa për punonjësit muaji gusht 2020, ne vlerën 2,862,790 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 14, datë 02.09.2020, është kryer pagesa për pagat muaji gusht 2020 në vlerën 28,683 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 15, datë 11.09.2020, është kryer pagesa për punonjësit sigurime shoqërore muaji gusht 2020, ne vlerën 950,615 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 16, datë 02.10.2020, është kryer pagesa për pagat e punonjësve shtator 2020, ne vlerën 2,955,614 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 17, datë 02.10.2020, është kryer pagesa për pagat e punonjësve shtator 2020, ne vlerën 29,753 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 18, datë 09.10.2020, është kryer pagesa për punonjësit sigurime shoqërore dhe shëndetësore 2020, ne vlerën 979,929 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 19, datë 03.11.2020, është kryer pagesa për punonjësit tetor 2020, ne vlerën 2,192,616 lekë;
Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

Rrogozhinë

Me Urdhër-shpenzimin nr. 4, datë 19.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore prill 2020, ne vlerën 579,194 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 5, datë 19.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore maj 2020, ne vlerën 565,532 lekë;
Me Urdhër-shpenzimin nr. 6, datë 19.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore qershor 2020, ne vlerën 553,942 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 7, datë 19.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore korrik 2020, në vlerën 533,154 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 8, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për paga gusht 2020, në vlerën 1,620,348 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 40, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për paga gusht 2020, në vlerën 60,622 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 41, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për paga gusht 2020, në vlerën 30,000 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 42, datë 02.09.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore gusht 2020, në vlerën 550,083 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 43, datë 01.10.2020, është kryer pagesa për paga shtator 2020, në vlerën 1,507,125 lekë;

Nga auditimi rezulton se nuk ka difference me shumën e raportuar te Banka Botërore.

Patos

Me Urdhër-shpenzimin nr. 2, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore dhjetor 2019, në vlerën 1,493,283 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 3, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore janar 2020, në vlerën 1,464,690 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 4, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore shkurt 2020, në vlerën 1,434,640 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 5, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore mars 2020, në vlerën 1,484,322 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 6, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore qershor 2020, në vlerën 1,473,518 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 7, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore korrik 2020, në vlerën 1,481,720 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 8, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për paga qershor – korrik 2020, në vlerën 8,535,152 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 9, datë 08.10.2020, është kryer pagesa për blerje klori, në vlerën 510,000 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 10, datë 08.10.2020, është kryer pagesa për paga shtator 2020, në vlerën 581,783 lekë;

Nga auditimi rezulton se ka një diferencë prej 40,892 lekë e raportuar më shumë të Banka Botërore nga shpenzimi faktik i subvencionit.

Vau i Dejës

Me Urdhër-shpenzimin nr. 3, datë 31.08.2020, është kryer pagesa për energji elektrike 1,063,400 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 5, datë 08.09.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore dhe shëndetësore korrik 2020 686,274 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 6, datë 08.09.2020, është kryer pagesa për pagat e punonjesve korrik 2020 729,414 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 7, datë 08.09.2020, është kryer pagesa për paga korrik 2020 559,200 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 8, datë 14.09.2020, është kryer pagesa për sigurime shoqërore gusht 2020 688,794 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 9, datë 14.09.2020, është kryer pagesa për paga punonjesish gusht 2020 791,467 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 10, datë 14.09.2020, është kryer pagesa për paga punonjesish gusht 2020 994,876 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 11, datë 07.10.2020, është kryer pagesa për paga shtator 2020 980,401 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 12, datë 07.10.2020, është kryer pagesa për paga shtator 2020 849,449 lekë;

Nga auditimi rezulton se ka një diferencë prej 343,275 lekë e shpenzuar më shumë se vlera e raportuar Banka Botërore (343,275 lekë gjendje në thesar nga viti 2019).

Kruja

Me Urdhër-shpenzimin nr. 1, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për energji elektrike në vlerën 18,580 lekë;

Me Urdhër-shpenzimin nr. 2, datë 01.09.2020, është kryer pagesa për energji elektrike në vlerën 19,371 lekë;

